

Para se të prezantoj në vija të përgjithshme buxhetin e mbrojtjes, do të them dy fjalë për mënyrën sesi është zhvilluar debati në orët e para të mëngjesit. Natyrisht, ne nuk presim duartrokitje nga opozita, është roli saj t'u mëshojë pikave të dobëta ose t'i ekzagjerojë ato. Natyrisht, qeveria kur prezanton buxhetin, e ka të legjitimuar ta shoqërojë me optimizmin, po të doni edhe me entuziazëm, për ato prioritete, të cilat ushqehen, furnizohen nga ky buxhet, i cili, për fat të mirë, është i mbushur me lajme të mira për shumë sektorë. Natyrisht, ju mund mos e thoni që është një arritje historike, në kuptimin e rritjes më të madhe në 30 vjet, rritja e pagave për të gjithë ushtarakët. Nuk janë pak, por janë mbi 6 mijë efektivë të FA-ve që do të kenë 30% më shumë të ardhura në buxhet. Ju e ekzagjeroni në ekstrem, deri në nihilizëm: "Ky buxhet nuk sjell asgjë për askënd, për asnjë fashë, për asnjë sektor".

Ja, pra, kemi një sektor, krahas shumë të tjerëve, por po flas më shumë për të, ku kemi një rritje jo deri në 30%, por 30% për të gjithë, nga ushtari i parë deri te gjeneralët. Kemi një rritje të buxhetit me 32% në total, kemi një rritje me 102% në zërin e investimeve, krahasuar me vitin korrent. Siç e thashë, është normale që ju të mos i lexoni këto shifra dhe të na lini ne radhën, por ajo që më le shije të keqe si politikan apo si një anëtar i klasës politike shqiptare është që debati politik këtu bëhet sikur ne të jemi jo ligjbërës, por ligzbatues, sikur të jemi organet e drejtësisë. Deri në vitin 2013 kishte një farë justifikimi gjuha shumë e ashpër me akuza dhe kundërakuzat në këtë sallë apo në arenën politike, sepse e pranoni të gjithë bashkë që kishim një drejtësi të pareformuar dhe, për sa kohë drejtësia nuk bën drejtësi, na takon të denoncojmë si qytetarë, si politikanë njëri-tjetrin apo këdo që ne mendojmë se e zgjidh punën e drejtësisë, e për këtë arsye, ju futëm punës së bashku për ta reformuar sistemin. E kemi votuar së bashku në këtë sallë reformën në drejtësi. Tani që flasim pjesa më e madhe sistemit është ngritur. Një pjesë e madhe ka dalë jashtë sistemit për shkak të vetingut, por tani çfarë duam që vazhdojmë të bëjmë prokurorin edhe gjykatësin, madje edhe policin? Kur do të ndahemi ne, si klasë politike, nga kjo histori? Kur do të bëjmë politikë për politika dhe jo akuza e kundërakuzat? Kur do të ndalojmë së neverituri që nga fëmijët e deri të gjithë shqiptarët, dhe kur do ta ndalojmë që ne të na vijë turp kur themi: jam politikan. Unë realisht e përdor këtë përcaktim për veten duke mu dridhur goja. Pra, nuk e them dot me mburrje: jam politikan. Këtë konotacion ia kemi dhënë ne vetë, dhe pastaj harrojmë që biem të gjithë në këtë pellg.

Ne nuk mund të pretendojmë që në krahun e majtë janë djajtë, ndërsa në krahun e djathtë janë engjëjt. Ne s'mund të jemi engjëj dhe djaj. As ne nuk jemi engjëj apo djaj, por as ju nuk jeni të gjithë engjëj apo të gjithë djaj. Jemi shqiptarë, jemi klasa politike, e cila shkon paralel me mesataren e zhvillimit ekonomik-shoqëror të Shqipërisë. Na takon që nga një legjislaturë tek tjetra, të bëjmë hapa përpara. Disa gjëra ju mbase mund t'i bëni më mirë se ne, po ky sistem që e kemi zgjedhur vet, na thotë që duhet të bindni popullin jo ne. Ne nuk na bindni dot se e bëni më mirë se ne. Ne mendojmë që dimë të bëjmë një buxhet më të mirë, të zbatojmë një buxhet më të mirë, të bëjmë punë më të mira për vendin, dhe kur ju nuk merrni vota nga populli, thoni: populli e ka gabim. Kësaj ne nuk kemi çfarë t'i bëjmë, por le të kthehemi tek etika e debatit apo te niveli i debatit në këtë sallë, sepse realisht na dëmton të gjithëve së bashku, duke na bërë te dukemi të gjithë njëllor. Jam shumë krenar për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes. Përmenda disa shifra që nuk mund të kontestohen. Jemi në 1.75% të GDP-së. Detyrimi në NATO është të shkojmë në 2%. Grafiku për të shkuar aty, deri në 2024, është: 1. 75% në 2022-shin; 1. 85% në 2023-shin dhe 2% në 2024. Më këtë buxhet po i përmbahem këtëj

grafiku, pra detyrimeve tona në NATO, po për më tepër po furnizojmë goxha mirë prioritetet dhe nevojat tona për modernizim, për një motivim më të mirë të personelit. Siç e thashë, rritja 30% është dinjitoze, motivuese dhe që na jep mundësi të rekrutojmë më mirë e më me shumë cilësi edhe në radhët e të rinjve, sepse natyrisht, një pagë që do të shkojë rreth 500 mijë lekë, të themi, apo diçka më tepër për ushtarin e parë, dhe deri te mbi 1 milion e gjysmë për gradat e larta të gjeneralëve, është motivuese. Buxheti për rindërtimin rritet me 65 %. Kemi shumë punë për të bërë, për të përmirësuar gatishmërinë. Pranojmë disa sfida ende të porealizuara siç duhet, në nivelin ku do të donim të ishin forcat tona në tokë, në ajër, në det, pa dyshim, por tani kemi një buxhet të mirë. Asnjëherë nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar të gjitha nevojat, por kemi një buxhet, i cili do të na financojë disa nga prioritetet tona, për të ngritur në një nivel tjetër gatishmërinë, për t'i furnizuar nevojat për modernizim.

E kam thënë edhe herë tjetër në këtë foltore: po aplikojmë edhe delegimin e blerjeve drejt agjencisë së specializuar të prokurimeve në NATO, ku besoj se në fund do të kemi më shumë fuqi negociuese dhe kontrata më të mira. Ky buxhet furnizon të gjitha ambiciet tona për të qenë pjesë e misioneve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, Bashkimit Europian, OKB-së. Aktualisht, jemi në Kosovë, Bosnje Hercegovinë, në Mali, në Sudanin Jugor, por kemi shprehur gatishmëri edhe për misione të tjera të NATO-s, që mund të fillojnë, si në Irak. Jemi pjesë e iniciativave rajonale, kemi marrë pjesë me shumë dinjitet në stërvitjen më të madhe të 30 viteve: Defender-21, dhe po përgatitemi për të qenë vend pritës për Defender-23. Përgatitjet, siç e dini, fillojnë më herët, kështu që kemi organizuar konferencën e parë për Defender-23. Do të jetë përsëri një ngjarje shumë e rëndësishme strategjike për Shqipërinë, nëse ne do të jemi, dhe me shumë gjasa do të jemi vendi pritës edhe i kësaj stërvitjeje. Tri fusha, si fjalë kyçe, që do të ecin me një shpejtësi të shtuar në këtë vit, financuar dhe nga ky buxhet, janë: edukimi ushtarak, Akademia e Forcave të Armatosura, e cila po rimodelohet sipas modeleve akademike ushtarake të vendeve partnere, kryesisht West Point në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kemi bashkëpunim shumë intensiv me ta. Inovacioni është një fjalë që do ta ndeshim shpesh në prezantimet që ne do të bëjmë për punët në Ministrinë e Mbrojtjes, sepse pranë Akademisë, por jo vetëm, do të instalojmë disa procese, të cilat nxisin inovacionin, siç e tha dhe ministri i Brendshëm, në mos gaboj, jo si luks, por si një nevojë në radhë të parë e vendeve më të vogla apo në zhvillim, për të kapur kohën e humbur dhe për të rritur shpejtësinë e avancimit. Siguria kombëtare kibernetike. Natyrisht, siguria kibernetike është pjesë e sigurisë kombëtare.

Ne deri tani, në fushën tonë të përgjegjësisë kemi sigurinë kibernetike të sistemeve të mbrojtjes, por vullneti politik, siç e keni dëgjuar dhe sot, është që Ministria e Mbrojtjes të bëhet një qendër gravitacionale për të ndërtuar kapacitete të mbrojtjes kibernetike jo vetëm për Ministrinë e Mbrojtjes, por dhe për sisteme të tjera të shtetit, si dhe të sektorit privat, të cilin do ta furnizojmë me politika standarde e rregullore, dhe natyrisht do të ngremë kapacitete për t'i inspektuar dhe certifikuar sistemet, që infrastruktura kritike me detyrim të ngrihet në Shqipëri, për ta çuar mbrojtjen kibernetike në një nivel tjetër. Meqenëse koha mbaroi, po e mbyll këtu, duke ju kërkuar ta votoni këtë buxhet. Besoj se zoti Mediu do ta votonte buxhetin e mbrojtjes, por ja që s'e votojmë dot të ndarë, kështu që votoni buxhetin e vitit 2022.